



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-107

**PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR MINISTRINË E FORCËS SË SIGURISË SË
KOSOVËS NR. 03/L-045, TË DATËS 15.06.2008**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR MINISTRINË E FORCËS SË SIGURISË SË
KOSOVËS NR. 03/L-045 TË DATËS 15.06.2008**

Neni 1

Neni 3.3 i Ligjit për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës riformulohet si vijon:

3.3 “Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës emërohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe mund të ndërrohet në pajtim me nenin 94 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Zëvendës Ministri[at] emërohen sipas ligjit në fuqi.”

Neni 2

Pas nenit 4 të Ligjit për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës shtohet një nen i ri 4.A:

“Neni 4.A Dispozita kalimtare

Ministri dhe Zëvendës Ministri(rat) i/e parë i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës do të emërohet nga Kryeministri pas miratimit të Ligjit për Ministrinë e FSK Nr. 03/L-045 të datës 15.06.2008 dhe Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës Nr. 03/L-046 të datës 15.06.2008, siç janë ndryshuar më pas.”

Neni 3

Ky Ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-107
10 nëntor 2008**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI